



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo

Institucion i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. KPDIM7912024

Nr./q.Bri.nr./nr.pg. _____

Data/Datum/Date: 03/12/2024

PRISHTINË/PRISTINA-PRISTINA



K.S

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 3 dhjetor 2024

Z. Alban Hyseni, kryetar i komunës
Bulevardi i Pavarësisë, p.nr.
60 000 Gjilan

LETËR REKOMANDIMI

R. nr.292/2024

I nderuari z. Hyseni,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 25 mars 2024, sipas informatave të pranuara me iniciativën e vet, sipas detyrës zyrtare, ka hapur hetime lidhur me sigurinë në objektin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët (ShFMU) "Dëshmorët e Kombit" në fshatin Livoq i Ulët, komuna e Gjilanit.

Sipas informatave, në një klassë të kësaj shkolle, ku nxënësit mbanin mësim, kishin rënë pjesë të gëlqeres nga tavani, duke rrezikuar jetën dhe shëndetin e nxënësve dhe të personelit të shkollës.

Lidhur me këtë, përfaqësuesi i Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), më 16 prill 2024, kishte biseduar me drejtorin e shkollës, me ç' rast ishte njoftuar se aktualisht gjendja e tavanit ishte rregulluar, mirëpo ai kishte vlerësuar se edhe një pjesë e korridorit të shkollës ishte e rrezikshme. Ai kishte pohuar se kryetari i komunës e kishte formuar një komision, i cili e kishte vizituar shkollën më 13.3.2024 dhe pritej të vendoset se cilat veprime do të ndërmerreshin nga Komuna, pasi shkolla në përgjithësi ishte e vjetër.

Më 2 korrik 2024, përfaqësuesi i IAP-së kishte biseduar me njërin anëtar të komisionit, nga i cili ishte informuar se komisioni i formuar nga kryetari i komunës, për vlerësimin e gjendjes në shkollë, kishte nxjerrë raportin përkatës të vlerësimit të gjendjes në shkollë.

Më 3 korrik 2024, përfaqësuesi i IAP-së, nëpërmjet postës elektronike, nga Komisioni për vlerësim të gjendjes fizike të objekteve shkolllore kishte pranuar raportin e datës 22.3.2024, i cili i ishte dorëzuar kryetarit të komunës dhe drejtoshës së DKA-së, sipas të cilit, ishte konstatuar dhe rekomanduar: objekti në të cilin gjendet shkolla, nuk ka stabilitet dhe qëndrueshmëri, prandaj objekti duhet të rrënohet dhe të ndërtohet objekti i ri.

Më 4 shtator 2024, pas fillimit të vitit shkollor, përfaqësuesi i IAP-së ka biseduar me drejtorin e shkollës, nga i cili është informuar se mësimi ka filluar dhe se një kompani e kishte fituar tenderin për punimin e projektit për ndërtimin e shkollës së re.

Në të njëjtën ditë, përfaqësuesi i IAP-së ka biseduar me arkitekten në kuadër të DKA-së, nga e cila është njoftuar se DKA-ja e ka dorëzuar tërë dokumentacionin në Zyrën për projekte në Komunë dhe se pritet realizimi i projektit për fillimin e ndërtimit të shkollës së re.

Më 6 shtator 2024, përfaqësuesi i IAP-së ka biseduar me drejtorin e sapoemëruar të DKA-së, lidhur me gjendjen e shkollës, me theks të veçantë në aspektin e sigurisë për nxënës. Drejtori i DKA-së ka pohuar se pritet të ndërtohet shkolla e re, mirëpo kjo mund të zgjasë, për këtë arsy do të shikohet mundësia e transferimit të nxënësve në një shkollë tjeter si dhe do të shikohet mundësia e meremetimit të tavanit në korridorin e shkollës.

Më 23 shtator 2024, përfaqësuesi i IAP-së ka biseduar me nënkyetaren e komunës së Gjilanit, lidhur me problemin e objektit të shkollës në Livoq të Ulët, e cila ka pohuar se ishte e njofuar për çështjen dhe do ta paraqesë atë edhe në bordin e drejtorëve.

Avokati i Popullit rikujton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton se secili individ gjëzon të drejtën për jetën (neni 25, paragrafi 1), po ashtu garantohet se fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre (neni 50, paragrafi 1), si dhe të drejtën e shkollimit të detyrueshëm pa pagesë, të financuar nga fondet publike (neni 47, paragrafi 1), prandaj Kushtetuta shprehimisht garanton të drejtat e fëmijëve dhe imponon detyrime ligjore për shtetin për t'i respektuar, mbrojtur dhe përmbushur këto të drejta.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e cila është pjesë përbërëse e Kushtetutës se vendit, në nenin 3, paragrafi 1, përcakton: “*Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.*” Gjithashtu sipas Konventës përcaktohet se shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë [...] (neni 24).

Edhe Ligji nr. 06/l-084 për Mbrojtjen e Fëmijës ka për qellim, pos të tjerash: “*Garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive për fëmijën, shëndeti dhe mirëgenia e të cilit janë në rrezik.*”

Për më tepër, ky ligj përcakton se të gjitha veprimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo nga kujdestari, nga institucionet, nga shërbimet përmbrrojtjen e fëmijës, nga profesionistët përmbrrojtjen e fëmijës, nga gjykatat, nga autoritetet administrative apo nga organet legislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe më e larta.

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (LAP), në nenin 3, paragrafi 3, përcakton: “*Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta përmbrrojtje, shëndetësia, nevojat e tyre specifike, si dhe përmbrrojtja e avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.*”

Po ashtu, neni 3, paragrafi 8, i LAP-it përcakton: “*Ministria, komuna, institucionet arsimore dhe aftësuese dhe komuniteti duhet ta bëjnë institucionin têrheqës dhe të sigurt përmbrrojtje, mësimdhënësin dhe prindërit, përmes përgjegjësive të tyre përkatëse përmbrrojtje, standardet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave shkolllore, shëndetësisë dhe sigurisë, ruajtjes së ambientit si dhe adresimit të çështjeve disiplinore dhe sjelljeve.*”

Gjithashtu, duke u bazuar në nenin 7, paragrafi 3, të LAP-it, përcaktohet se komunat kanë përgjegjësi shtesë për: ndërtimin e objekteve arsimore dhe aftësuese, mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucioneve arsimore, sigurimin e një ambienti të shëndetshëm, duke përfshirë ujin e pijshëm, kushtet higjenike sanitare, shërbimin shëndetësor, si dhe ambient të sigurt për nxënësit dhe personelin, duke përfshirë sigurimin e shërbimeve të sigurta dhe të sigurisë efektive.

Më tutje, Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës (LAK), në nenin 5, pika a, ka përcaktuar: “*Ndërtimin e objekteve shkollore në pajtueshmëri me Kapitullin 3 të këtij ligji dhe me ligjet e tjera në fuqi.*”

Neni 8 i LAK-it (Kompetencat e komunave) përcakton: “*Objektet arsimore publike mund të ndërtohen nga komuna dhe të financohen nga buxheti i komunës dhe donacionet tjera. (...) 8.4 Shkollat do të kenë buxhetin e tyre të ndare nga Komuna.*”

Duke u bazuar në Vendimin nr.02-274 të kryetarit të komunës, të datës 21.2.2024, për Vlerësimin e gjendjes fizike në objektet e shkollave në komunën e Gjilanit, ishte formuar komisioni për vlerësimin e gjendjes së objektit të ShFMU “Dëshmorët e Kombit” në fshatin Livoq i Ulët.

Më 13 mars 2024, komisioni kishte filluar punën dhe kishte dalë në vendin e ngjarjes dhe lidhur me gjendjen e objektit të shkollës ishte përpiluar raporti, sipas të cilit, konstatohej: “*Më datën 30.11.2023 ka ra një pjesë e tavanit në njëren prej klasave duke rrezikuar edhe jetën e nxënësve dhe se kjo pjesë është përmirësuar më datën 01.12.2023, tavani i shkollës është i plasaritur dhe i dëmtuar në shumicën e hapësirave dhe paraqet rrezik për mbajtjen e procesit mësimor, në korridor të shkollës duket edhe trau mbajtës duke rrezikuar të bjerë në dysheme, në muret e klasave ka shumë plasaritje dhe lagështi duke krijuar kushte të vështira dhe rrezik për mbajtjen e procesit mësimor, krijimi i mykut i rrezikshëm për shëndetin e nxënësve dhe mësimdhënësve. Po ashtu, lidhjet e mureve kanë plasaritje dhe paraqesin rrezik për stabilitetin e objektit, dyshemetë e klasave vibrojnë gjatë ecjes dhe kanë ulje, ndërsa gjenda e tualetave është shumë e rëndë dhe shumica e tyre janë jashtë përdorimit.*”

Në fund të raportit, në bazë të gjendjes në shkollë dhe vlerësimit, komisioni kishte rekomanduar që objekti duhet të rrënohet dhe të ndërtohet objekti i ri.

Rrjedhimisht, duke pasur parasysh se deri në ndërtimin e objektit të ri të shkollës, është e nevojshme një periudhë më e gjatë kohore, në mënyrë që të mos rrezikohetjeta dhe shëndeti i fëmijëve dhe i personelit të shkollës gjatë kësaj periudhe, autoritetet përgjegjëse duhet të gjejnë një zgjidhje, në mënyrë që të garantojnë një ambient të sigurt për nxënësit dhe për personelin gjatë qëndrimit në shkollë, po ashtu të garantojnë përkujdesjen efektive përfëmijët, shëndeti dhe mirëqenia e të cilëve janë në rrezik.

Në drejtim të kësaj, Avokati i Popullit vlerëson se vazhdimi i mësimit në objektin e ShFMU-së “Dëshmorët e Kombit” në fshatin Livoq i Ulët, në këto kushte, paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve dhe të personelit të shkollës, prandaj institucionet përgjegjëse duhet ta trajtojnë me prioritet çështjen në fjalë. Vonesat për gjetjen e një zgjidhjeje janë në kundërshtim me fryshten e dispozitave të lartekura, të cilat garantojnë të drejtat e fëmijëve dhe detyrimet e shtetit përfshirë ofruar dhe mbrojtur ato.

Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Kryetarit të Komunës së Gjilanit dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjilan:

- Pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmarrin të gjitha masat e duhura për t'ua siguruar të gjithë fëmijëve një mjedis shkollor të shëndetshëm, të sigurt dhe të përshtatshëm, sipas normave dhe standardeve që mundësojnë mësim cilësor.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*”) dhe me nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.*”), ju lutemi mirësish të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

